



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:277815
Datë: 16.02.2024
Numri i dokumentit: 05337622

C – IV. – 15 – 0718

Paditësi :

Sh R K nga Lipjani.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55 , Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i pagave të pa paguara.

Për: Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, jashtë seancës gjyqësore, me dt.16.02.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, Sh R K nga Lipjani, e parashtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe lidhur me Vendimin e Autoriteti i Likuidimit (AL) i Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, PRN052 - 1365 të dt.13.09.2013 dhe i njëjti Vendim, **VËRTETOHET si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me dt.30.04.2015, paditësi, Sh R K nga Lipjani, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DhPGJSK), ka parashtruar padi kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN052 - 1365 të dt.13.09.2013, e me të cilin, paditësit i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 2,960.00 € nga NSh "Ferronikeli" me seli në Glllogoc (në likuidim), nga e duke u bazuar në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, dhe i cili parasheh se :” elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo

interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme” si dhe në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: *“Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”* e më gjerësisht si në arsyetimin e këtij Vendimi të AL-së.

Paditësi në padinë e tij thekson se, e paditura pasi ka hapur procedurën e likuidimit të NSh, “Feronikeli” me seli në Glllogovc (Drenas) në likuidim, ka marrë dokumentacionin e kësaj NSh, në të cilin dokumentacion ka qenë edhe evidenca e shumë të punësuarve të cilëve nuk u janë paguar të ardhurat për periudhën dhjetor 1997- maj 1999, në të cilën bënë pjesë ehe vetë paditësi, dhe se me vendimin e të paditurës i është refuzuar kërkesa për kompensim, duke e konsideruar Vendimin e AL-së në tërësi si të kundërligjshëm në dëm të paditësit, pas që thirret në parashkrimin e kërkesëpadisë mbështetur në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, i cili nuk prodhon efekt juridik dhe se e paditura ka bishtnuar përmbushjen e obligimeve që ka pasur ndaj punëtorëve të NSh “Feronikeli” në likuidim duke u shërbyer me të dhëna të pavërteta, se paditësi ka bërë kërkesën me shkrim dt.17.07.2007, që ti paguhen të dhënat personale në shumë prej 2,600.00 euro, ndërsa më tej shton se e paditura në mënyrë selektive disa punëtorëve ia ka paguar këto të ardhura në kushte plotësisht të pabarabarta dhe të ngjashme dhe disa punëtorëve tjerë, ia ka refuzuar këtë të drejtë.

Padisë/ankesës së tij si prova, paditësi, ia ka bashkëgjetur vetëm, Vendimin e AL-së, PRN052-1365 të dt.13.09.2013, e asnjë provë tjetër.

Me dt.14.11.2023, e paditura AKP me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë ka parashtruar mbrojtjen e saj në ankesën e paraqitur nga pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit, ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, se ankesa e parashtruesit është e pa pranueshme pasi që objekt i kësaj procedure gjyqësore, është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria e me Ligjin, Nr.04/L-034) e Vendimit të AL-së, dhe se në këtë kontekst, neni 74.2 i Ligjit, nr.06/L-086, parashikon se ankesa e dorëzuar në DhPGJS kundër Vendimit të AL-së, duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit, nuk është kryer në përputhje me Ligjin, nr.04/L – 034 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, se parashtruesi nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore që e ka shkelur Autoriteti i Likuidimit (AL), andaj vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit nr.04/L -034, dhe se nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin, dhe se ankesa është e pavlefshme. E paditura, më tej në këtë mbrojtje, ka cituar se ankesa është e pabazuar në pajtim me nenin 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, se AL-ja ka kryer vlerësimin e kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku parashikon se : *“ ... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”*, dhe nga nenin 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK 1999/24, parashikon që: *“pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”*, në bazë të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë organ tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës nga viti 1997, nga momenti kur parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pa bazuar

dhe t'a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit, Nr.06/L – 086 dhe se mbrojtjes si provë i ka bashkëngjitur: Vendimin e AL-së, PRN052-1365 të dt.13.09.2013.

Me Urdhrin e saj, C – IV. – 15– 0718 të dt. 15.11.2023, kjo gjykatë, mbrojtjen e të paditurës, ia ka adresuar paditësit, për të dhënë përgjigje në këtë mbrojtje, dhe atë brenda afatit prej 7 ditëve, dhe në përgjigjen e dhënë duhet t'ia bashkëngjiti provat që posedoni në mbështetje të padisë, të pranuar nga paditësi dt.21.11.2023, por nuk i është përgjigjur gjykatës.

Me dt.30.01.2023, me Aktvendimin e saj, C – IV. – 15– 0718 të dt.30.01.2023, kjo gjykatë, ka urdhëruar, paditësin, Sh R K nga Lipjani, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, të bëjë plotësimin e padisë së tij të paraqitur pranë DhPGJSK-së me dt.30.04.2015 dhe atë kundër të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë e që ka të bëjë me Vendimin e AL-së, PRN052 - 1365 të dt.13.09.2013 për shkak të kompensimit të pagave të pa paguara e në shumën prej 2.960.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore, (NSh) "Ferronikeli" me seli në Glllogoc, në atë mënyrë që për gjykatën, të siguroj të dhënat se sa ka qenë paga e tij mujore si dhe kësaj padie, t'ia bashkëngjes, kopjen e Njoftimit të AKP-së për përfundimin e punësimit tek kjo NSh, kopjen e librezës së punës lidhure me këtë Ndërmarrjen Shoqërore, listën e pagave si dhe provat tjera në mbështetje të padisë së tij e nën kërcënimin e pasojës gjegjëse ligjore në rast të mos veprimet sipas këtij aktvendimi.

Me dt.13.02.2024, përmes dërgimit me postë, paditësi, kësaj gjykate, ia ka dërguar provat gjegjëse siç janë : kopja e certifikatës për gjendjes shëndetësore, nr.1301 të dt.14.IX.1983, kopjen e aktvendimit të dt.2.02.1998 të Shoqërisë Aksionare (ShA) "Ferronikeli" me seli në Glllogoc për kryerjen e detyrave të punës së paditësit, kopjen e aktvendimit, nr.1416/8 të dt.12.07.1997 të dt.2.02.1998 të NUSH, "Ferronikeli" me seli në Glllogoc për sistemimin në vendin e punës së paditësit, kopjen e vërtetimit të dt.5.5.1980, DO" Ljubeçna, Celje, kopjen e aktvendimit, nr.1416/8 të dt.08.07.1993 të NUSH, "Ferronikeli" me seli në Glllogoc për sistemimin në vendin e punës së paditësit, kojen e Qertifikatës së lëshuar nga Sekretariati i Mbrojtjes Popullore, kopjen e kërkesës së paditësit e dt.18.07.1983 së drejtuar Xehrores së Niklit për inkuadrim në punë; kopjen e aktvendimit, nr.1416/6 të dt.28.10.1988 të NUSH, "Ferronikeli" me seli në Glllogoc për sistemimin në vendin e punës së paditësit, kopjen e aktvendimit, nr.1416/8 të dt.08.07.1993 të OP, "Ferronikeli" me seli në Prishtinë për sistemimin në vendin e punës së paditësit, kopjen e aktvendimit, nr.1416/3 të dt.28.02.1985 të OP, "Ferronikeli" me seli në Glllogoc për sistemimin në vendin e punës së paditësit, kopjen e aktvendimit, nr.1416/1 të dt.09.12.1983 të OPTH, "Ferronikeli" me seli në Medvec për caktimin e detyrave të punës në vendin e punës së paditësit, kopjen e Letër konfirmimit të AKP-së së dt.13.02.2024 për periudhën kohore të marrëdhënies së punës së paditësit tek NSh, "Feronikeli" me seli në Glllogoc, kopjen e listës së punëtorëve të kësaj NSh-je për librezat e punës etj., kërkesën e paditsit të dt.12.02.2024 të drejtuar tek AKP-ja për të dhënat gjegjëse, kopjen e ID-së, dhe kopjen e librezës së punës lidhur me këtë NSh.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *"Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është*

e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”

Po ashtu në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit, Sh R K nga Lipjani, duhet të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i kontestuar i Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN052-1365 i dt.13.09.2013, duhet të vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e padisë/ankesës së paditësit.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret padia/kërkesa e paditësve, pranë DhGJSK-së, e plotëson kriterin e pranueshmërisë së saj nga dispozitat e lartë cekura ligjore por se e njëjta padi/kërkesë, pranë e DhPGJSK-së, nuk i plotëson kriterin e bazueshmërisë së saj sepse para bërjes së padisë së paditësit pranë DhGJSK-së, paditësi, në procedurën e likuidimit, kërkesën e tij pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), e ka dorëzuar 30 (tri dhjetë) ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesave dhe se për këtë arsye, AL-ja, me Vendimin e tij, PRN052-1365 të dt.13.09.2013, kërkesën e paditësit, e kishte refuzuar si të pa vlefshme e me arsyetimin se kjo kërkesë, ishte bërë me dt.17.07.2007 e që jashtë afatit për dorëzimin e kërkesave sepse afati për dorëzimin e kërkesës tek AL-ja, në procedurën e likuidimit, ka qenë deri me dt.26.09.2006.

Në nenin 36 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) që flet për pranueshmërinë e një kërkesë/ankese, aty thuhet se: *’... Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; paditësi ka të drejtë të nisë procedurat në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; kërkesa/ankesa paraqitet kundër një pale që mund të jetë palë kundërshtare në procedurat para Dhomës së Posaçme, në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; kërkesa/ankesa është parashtruar brenda afatit të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera në fuqi kur janë të aplikueshme ...’.*

Ndërsa lidhur me çështjen e afatit për të paraqitur një kërkesë në gjykatë nga një palë kreditore, në nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, parashihet se: *’Kreditore i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kerkimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit ...’.*

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se paditësit me të paditurën, Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), “Feronikeli” me seli në Gllogovc (Drenas) në likuidim, kanë pasur raport juridik të lëmisë së marrëdhënies së punës dhe se e paditura, NSh-ja në fjalë por kontestuese mbetet çështja e bazueshmërisë së kërkesëpadisë së tyre e paraqitur përmes padisë së paditësve e paraqitur në DhPGJSK kundër NSh, Feronikeli” me seli

në Gllogovc (në likuidim) sepse kërkesa e tij në procedurën e likuidimit, është bërë pas kalimit

të afatit prej 30 ditëve për paraqitjen e saj pranë Autoritetit të Likuidimit (AL) dhe se për këtë arsye, Autoriteti i Likuidimit (AL), me Vendimin e tij, PRN052-1365 të dt.13.09.2013, kërkesën e paditësit, e ka refuzuar si të pa vlefshme e me arsyetimin se ajo në procedurën e likuidimit, është bërë me dt.17.07.2007 e që jashtë afatit për dorëzimin e kërkesave (afati për dorëzimin e kërkesës, ka qenë i paraparë deri me dt.26.09.2006) dhe atë duke u bazuar në nenin 36 par.2. pika 2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) lidhur me nenin 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë .

Po ashtu në nenin 35 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, që flet për Njoftimin për kreditorin dhe afatin për parashtrimin të kërkesave, aty parashihet se : *''Në pajtim me nenin 7 të kësaj Shtojce, Autoriteti i Likuidimit publikon njoftim në pajtim me Dispozitat për shpallje duke u bërë thirrje të gjithë kreditorëve dhe bartësve të interesit që t''i parashtrojnë Dëshmitë e tyre të Kërkesës dhe të Interesit. Nëse Autoriteti i Likuidimit është duke shqyrtuar nëse një kërkesë është parashtruar si duhet brenda afatit përkatës kohor, ai trajton dërgimin e kërkesave në Agjenci si pezullim të llogaritjes së periudhës kohore pas asaj dërgese. Nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë dëshminë e kërkesës apo interesit të dorëzuar pas afatit për Parashtrimin e Kërkesave, nëse dëshmia e Kërkesës apo i Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas afatit për Parashtrimin e Kërkesave''.*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësi në procedurën e likuidimit, kërkesën e tyre ndaj Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), "Ferronikeli" me seli në Gllogoc (në likuidim), kanë pasur afat që t'a bëjnë deri me dt.26.09.2006 kurse kërkesë e tij për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 2,960.00 € nga NSH "Ferronikeli" me seli në Gllogoc (në likuidim), në procedurën e likuidimit në AL, e ka bërë me dt.17.07.2007, pra që është jashtë afatit të paraparë ligjor prej 30 ditë për paraqitjen e saj në Autoritetin e Likuidimit (AL) dhe se për këtë arsye, Autoriteti i Likuidimit pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me Vendimin e tij, PRN052-1365 dt.13.09.2013, kërkesën e tillë të paditësit, e ka refuzuar si të pa vlefshme.

Gjykata, nuk i mori për bazë pretendimet e palës paditëses dhe të palës së paditur, sa i përket çështjes së parashkrimit të kërkesës nga neni 36 par.2 pika 2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në dhe neni 608 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë pasi që kërkesa e paditësit në procedurën e likuidimit, është bërë pas kalimit të afatit të paraparë ligjor për paraqitjen – dorëzimin e kërkesave.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.

Gjykata vlerëson se qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së të se kërkesa e paditësit në procedurën e likuidimit, është refuzuar si epa vlefshme e me arsyetimin se ajo në procedurën e likuidimit, është bërë me dt.17.07.2017 e që jashtë afati për dorëzimin e kërkesave (afati për dorëzimin e kërkesës, ka qenë deri me dt.26.09.2006) dhe atë duke u bazuar në nenin 36 par.2. pika 2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) lidhur me nenin 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë është bërë pas kalimit të afatit 30 ditor për dorëzimin e kërkesave te Autoriteti

i Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), andaj me arsyet e cekura më

lartë, kjo gjykatë gjeti se kërkesëpadia e paditësit, Sh R K nga Lipjani, si ish punëtor i Ndërrmarrjes Shoqërore (NSh), “Ferronikeli” me seli në Glllogoc (në likuidim) për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 2,960.00 euro nga NSh “Ferronikeli” me seli në Glllogoc (në likuidim), duhet të refuzohet si e pabazuar për shkak se në procedurën e likuidimit, kërkesa e tij, është bërë pas kalimit të afatit të paraparë ligjor prej 30 (tridhjetë) ditëve për dorëzimin e kërkesave te Autoritetit të Likuidimit (AL) pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), dhe Vendimin e AL-së, PRN052-1365 të dt.13.09.2013, e vërtetoj si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, 33, 35, 36, 42, 54, dhe nenit 74 të Ligjit nr.06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Shpenzimet Gjyqësore.

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata, vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:277815, 16.02.2024

**Gjykatësi
Agron J. Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).